



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .06.2020

NJOFTIM

**Për mbledhjen Nr. 27, datë 02.07.2020, ora 12:30
të Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 02.07.2020, ora 12:30** do të zhvillohet mbledhja nr. 27 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

- 1-** Mbi miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike
- 2-** Mbi kërkesën e shoqërisë MTC Energy sh.p.k., për transferimin e asetëve të saj nga "Raiffeisen Bank" sh.a, tek “Alpha Bank”
- 3-** Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 187 datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 188 datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar.
- 4-** Për disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 221, datë 20.12.2020, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i kombinuar i gazit natyror” Albgaz sh.a.” të ndryshuar”
- 5-** Mbi kërkesën e shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s, nr. 86, datë 12.05.2020, “Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë “Solaris Power” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”
- 6-** Mbi plotësimin e kushtit të vendimit nr. 80, date 04.05.2020 “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k, nr. 291, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”

7- Të tjera

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI